



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:191259

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05740717

C.nr.3255/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional D.K. duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses S.Gj. me numër personal nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës M.A.Sh.T.-A.A.P.A.Rr. me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me objekt kontesti kompensimin e inflacionit në pagë, vlera e kontestit 579.75 euro, jashtë seance, me datë 25.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses S.Gj. nga Prizreni, ashtu që **DETYROHET** e paditura M.A.Sh.T.- A.A.P.A.Rr. me seli në Prishtinë, që paditësja të kompensohet në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:

1. Për periudhën kohore 01.09.2019 - 31.12.2019, shumën prej 49.57 euro;
2. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, shumën prej 11.01 euro;
3. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, shumën prej 187.27 euro;
4. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 30.06.2022, shumën prej 319.46 euro;

Në shumën e përgjithshme prej 567.30 (pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë euro e tridhjetë cent), me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 19.09.2022, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. REFUZOHET pjesërisht pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, në shumën prej **12.39** euro, në emër të pagesës mbi bazën e inflacionit për periudhën (01.08-31.08.2019), **si e pa bazuar.**

III. DETYROHET e paditura, që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej **124.00 (njëqind e njëzetë e katër) euro,** në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja S.Gj. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj av. A.H. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate me datë 19.09.2022 ka parashtruar padi kundër të paditurës M.A.Sh.T.- A.A.P.A.Rr.

me seli në Prishtinë, ndërsa përmes parashtrësës së datës 03.04.2024 ka precizuar kërkesëpadinë, duke kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune në institucionin arsimor-Agjencinë për Aftësimin Profesional dhe Arsim për të Rritur dhe gjatë kësaj periudhe nuk ka pranuar mjete e parapara për kompensimin e shpenzimeve të inflacioni në pagë, dhe bazuar në nenin 35 par. 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Shuma për kompensimin sipas inflacionit në vend për periudhën kohore 01.08.2019-30.06.2022, paditësës i takon shuma në lartësi prej 579.75 euro.

Po ashtu, ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësës vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar në shumë prej 228 euro.

E paditura M.A.Sh.T.- A.A.P.A.Rr. përmes Avokaturës Shtetërore në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 11.11.2022, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Ka theksuar se sipas nenit 90 para.4 të Ligjit të Punës “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”. Po ashtu bazuar në nenin 341 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve përcaktohet “Me parashkrim shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit. Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit. Gjykata nuk mund të merr parasysh parashkrimin, në qoftë se debitori nuk thirret në atë”. Po ashtu bazuar në këtë dispozitë ligjore MASHT-AAAPARR konsideron se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë nr.01B/2056 e datës 18.04.2017 është shfuqizuar në bazë të nenit 47 të Kontraës Kolektive e Arsimit në Kosovë nr.01B/105 e datës 22.01.2021, gjithashtu bazuar edhe në faktin se MASHT me datën 21.11.2022 është tërhequr nga Kontrata Kolektive nr.prot.01B/105 e datës 22.01.2021 e Arsimit në Kosovë dhe si e tillë kjo kontratë nuk mund të zbatohet. Në fund ka theksuar paditësja me asnjë provë të vetme nuk ka dëshmuar se ishte anëtar i SBASHK-ut, ashtu siç parashihet në dispozitën ligjore të nenit 35 par.8 dhe 9 të Kontratës Kolektive nr.01/B105 të datës 22.01.2021 të Arsimit në Kosovë. Duke u bazuar në thëniet e cekura më lartë e paditura kërkon që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësës. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësës është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës me numër 167/3 e datës 13.10.2017, për paditësen e lëshuar nga Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, në “Qendrën e Kompetencës” në Prizren, si mësimdhënëse, nga vërtetimi me numër të prot.

6/10-2024 i datës 26.01.2024, vërtetohet fakti se paditësja tek e paditura është në marrëdhënie pune që nga data 01.09.2014 e vazhdon tutje. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditëses e që është shuma prej 459 euro. Nga kërkesa me numër të protokollit 1044 e datës 16.05.2022, vërtetohet se paditësja dhe të tjerët i janë drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës - Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, por nuk kanë marrë përgjigje. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që “Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve” ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën 19 Shtator - Dhjetor 2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2019 ka qenë 459 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 40.88 euro ($459 \times 2.7\% = 12.39 * 4 \text{ muaj} = 49.57$).
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2020 ka qenë 459 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 11.01 euro ($459 \times 0.2\% = 0.91 * 12 \text{ muaj} = 11.01$).
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 459 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 187.27 euro ($459 \times 3.4\% = 15.60 * 12 \text{ muaj} = 187.27$).
- Për periudhën Janar 2022 - Qershor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka

qenë 459 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 319.46 euro ($459 \times 11.6\% = 53.24 * 6 \text{ muaj} = 319.46$).

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata konstaton se me paraqitjen e padisë, në gjykatë më datë 19.09.2022 në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 01.09.2019 e deri më 30.06.2022, edhe përkundër faktit se padia është parashtruar më datë 19.09.2022. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë në tërësi për muajin shtator 2019 respektivisht nga data (01.09.2019) pasi që parashkrimi për kërkesën e paditëses për muajin shtator 2019 ka filluar të rrjedh vetëm pasi që i njëjti ka pranuar pagën e muajit shtator 2019, e cila pagë realizohet në fund të muajit shtator 2019 rrjedhimisht i njëjti atëherë është njoftuar se e paditura nuk ka përmbushur detyrimin për kompensimin e inflacionit për muajin shtator 2019 dhe nga fillimi i muajit vijues saktësisht 01 tetor 2019, i njëjti ka mundur të kërkoj përmbushjen e detyrimit, në bazë të nenit 342 të LMD-së, parashihet që *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Duke u bazuar në dispozitat e lartcekura gjykata konstaton se padia e paditëses për periudhën 01.09.2019 e deri më 30.06.2022, nuk është parashkruar pasi që nuk është arritur afati i paraparë me neni 87 të LP-së.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, pasi që gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Në këtë drejtim, paditësja padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 19.09.2022. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditëses iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 01.08.2019 deri më datë 31.08.2019. Më konkretisht, sipas llogaritjes së gjykatës, një kërkesë e tillë është parashkruar për 1 muaj apo në shumën prej 12,39 euro, ndërsa paditësja e ka ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe e ka ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së tij në procedurë gjyqësore nga data e paraqitjes së padisë respektivisht nga data 19.09.2022, në bazë të lartcekurave. Gjykata vendosi si në dispozitiv bazuar në listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës, ku vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditëses, e që është shuma prej 459 euro. Rrjedhimisht shuma e përgjithshme e refuzuar në lartësi prej 12,39 euro është për periudhën 01.08.2019 deri më 31.08.2019 si kërkesë e parashkruar. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht

kërkesëpadinë e paditëses sikurse në pikën nën I. të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën II. të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (19.09.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, përkatësisht për precizimin e padisë në shumë prej 104.00 euro meqenëse kompensimi caktohet vetëm për shpenzimet e krijuara lidhur me lëndën në gjykatë. Për më tepër nuk mund të kërkohet kompensim për secilën parashtrësë të deponuar në gjykatë e posaçërisht jo lidhur me parashtrësën e dorëzuar sipas aktvendimit për plotësimin e padisë, duke qenë se parashtrësja gjegjësisht padia fillestare ka pasur të meta.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.3255/2022, datë 27.05.2024

G j y q t a r i

Taulant Rexhëbeqaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.